



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

BASHKIA VLORË¹
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE
DREJTORIA E FINANCES BUXTETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 9817 prot.

Vlorë, më 20.06 2025

PROJEKTVENDIM

Nr. , Datë . . .2025

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB NR.111, DT.27.12.2024
PËR BUXTETIN E BASHKISË PËR VITIN 2025, I NDRYSHUAR**

Ne baze te Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8, pika 2, 9 pika 1.1 b, 34, 35, 36, 37,40, 41, 54 pika dh, dhe neni 64 pika c , Ligji nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 45, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 44 ; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarte të Menaxhimit të Buxhetit”, Udhëzimi plotësues nr.2 datë 24.01.2025 “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2025”, V.K.B nr.111 datë 27.12.2024 “Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2025”. i ndryshuar

VENDOSI:

1.Të miratojë vlerën financiare për realizimin e projektve kulturore .

Në kuadër të realizimit të aktiviteteve të cilat forcojnë dhe mbështesin identitetin turistik të qytetit të Vlorës, përkatësisht: Koncerti festiv “*Dans Music Fest 2025*” i cili parashikohet të zhvillohet në datat 18-23 gusht, në Lungomare, aktiviteti “*Miss dhe Mister Turizmi*”, i cili do të zhvillohet në datën 4 korrik 2025, si dhe realizim fotografish me rezolucion e cilësi të lartë, në funksion të promovimit të plazheve të Bashkisë Vlorë, ardhur si kërkesë në kuadër të strategjisë së Marketingut të Agjencisë Kombëtare të Turizmit për promovimin e plazheve në aplikacionin TEA dhe rrjetet sociale.

Nr	Pershkrimi	Leke
1	Koncertin festiv “ <i>Dans Music Fest 2025</i> ”	3,000,000
2	Fotografim për AKT, ku do të realizohen fotografi me cilësi dhe rezolucion të lartë	1,000,000
3	“ <i>Miss & Mister Turizmi</i> ”	400,000
		4,400,000

2.Finacimi i Projekteve te mesiperm do te behet duke paksuar fondet nga projektet e meparshme te miratura si me poshte:

a) Pakësohen Projektet Kulturore ne Gr. 00.Titull (1110) ,Kapitull 5 Artikull 602

1	Turneu Ndërkombëtar i Beach Voley në Vlorë 2025.	1,000,000
2	Vlora Marathon 2025”	1,000,000
3	Panairi në Bari, Itali	2,000,000
4	Panairi në Berlin , Gjermani	400,000
		4,400,000

b) Shtohen projektet Kulturore ne Gr. 00.Titull (1110) ,Kapitull 5 Artikull 602

Nr	Pershkrimi	Leke
1	Koncertin festiv “Dans Music Fest 2025”	3,000,000
2	Fotografim për AKT, ku do të realizohen fotografi me cilësi dhe rezolucion të lartë	1,000,000
3	“Miss & Mister Turizmi”	400,000
		4,400,000

3.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë .

4.Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në VKM nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55, pika 6.

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE, TURIZMIT DHE
SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE TURIZMIT**

Vlorë, më _____. ____ 2025

RELACION ARGUMENTUES

FESTIVALI DANSMUSIK FEST 2025

Në funksion të zhvillimit strategjik të turizmit dhe konsolidimit të identitetit kulturor dhe veror të qytetit të Vlorës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, Bashkia e Vlorës është përfshirë në mbështetjen e aktiviteteve me impakt të gjerë turistik. Në këtë kuadër, është paraqitur një kërkësë pranë Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit nga organizatorët e festivalit DansMusik Fest 2025, një ngjarje që parashikohet të zhvillohet përgjatë datave 18-23 gusht 2025, në zonën e Lungomares, Vlorë.

1-Impakti turistik dhe ekonomik i festivalit:

Edicioni i kaluar, DansMusik Fest 2024, me performacën e DJ ndërkombëtar, Steve Aoki ku rezultoi një sukses domethënës me mbi 25,000 vizitorë të ardhur në qytet, dhe një impakt ekonomik të përllogaritur në rreth 1.5 milion euro, siç është raportuar nga mediat ndërkombëtare si PR News & Newswire. Ky ndikim përfshiu rritjen e menjëherësme të kapaciteteve të prenotuara në hotele, restorante dhe biznese të tjera vendore, duke konfirmuar vlerën e festivalit si një instrument i fuqishëm për zhvillimin ekonomik vendor dhe nxitjen e punësimit sezonal.

2-Pozicionimi i Vlorës si një qendër kulturore dhe turistike në Ballkan:

Duke synuar të sjellë artistë me famë ndërkombëtare, përfshirë pjesëmarrjen e konfirmuar të DJ ALOK, DansMusik Fest përforcon pozicionimin e Vlorës në hartën e destinacioneve evropiane të muzikës dhe argëtimit. Ky pozicionim sjell përfitime të drejtpërdrejta në perceptimin ndërkombëtar të qytetit dhe kontribuon në promovimin e Shqipërisë si vend mikpritës i ngjarjeve me standarde të larta organizimi.

3-Qasje gjithëpërfshirëse për publikun dhe komunitetin:

Organizatorët kanë theksuar rëndësinë e aksesit të lirë ose me tarifa simbolike për qytetarët dhe vizitorët, duke garantuar përfshirje sociale dhe kulturore të gjerë. Kjo qasje përpunhet me objektivat e Bashkisë së Vlorës për të garantuar kulturë të aksesueshme për të gjithë dhe për të nxitur aktivizimin qytetar dhe ndërveprimin komunitar.

Duke marrë parasysh suksesin e provuar të festivalit, ndikimin e drejtpërdrejtë në sektorët ekonomikë lokalë, rolin në promovimin ndërkombëtar të qytetit dhe karakterin gjithëpërfshirës të ngjarjes, rekomandohet shqyrtimi pozitiv i kësaj kërkese për mbështetje financiare.

DansMusik Fest 2025 përfaqëson një projekt me potencial të iartë zhvillimi dhe përforcon identitetin e Vlorës si një qytet i gjallë, dinamik dhe mikpritës për kultura të reja dhe ngjarje me përmasa europiane.

FOTOGRAFIMI CILËSOR

Në kuadër të misionit për promovimin e turizmit vendas dhe përmirësimin e përvojës së vizitorëve, Agjencia Kombëtare e Turizmit ka zhvilluar aplikacionin TEA 3.0 – Tourism Events of Albania, një platformë digitale me informacion gjithëpërfshirës për destinacionet bregdetare, ngjarjet kulturore, shërbimet turistike dhe raportimin në kohë reale të problematikave nga përdoruesit.

Në këtë kuadër, vlerësohet e nevojshme dhe e përshtatshme që Bashkia Vlorë të mbështesë vendosjen e spoteve promovuese të aplikacionit në hapësirat reklamuese që ajo menaxhon – në rrugë, sheshe, zona publike apo pika me intensitet të lartë vizitorësh – në funksion të promovimit të qytetit si një destinacion modern, transparent dhe mikpritës.

Rëndësia e fotografimit cilësor:

Për të arritur një prezantim dinjitoz dhe tërheqës të Vlorës në këtë aplikacion dhe në materialet promovuese, fotografimi cilësor është një komponentë thelbësore. Ai:

- Krijon një përshtypje të parë profesionale dhe nxitëse për vizitorin;
- Reflekton bukuritë natyrore, trashëgiminë dhe jetën kulturore të qytetit;
- Forcon identitetin vizual të Vlorës si markë turistike;
- Rrit ndikimin e përbajtjes në rrjete sociale dhe në faqet promocionale;
- Siguron materiale të përdorshme në afatgjatë për qëllime informuese dhe promovuese.

Vendosja e spoteve promovuese të aplikacionit TEA 3.0 dhe realizimi i fotografive cilësore për destinacionet dhe aktivitetet në territorin e Vlorës do të kontribuojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e vizibilitetit të qytetit dhe të përvojës së turistëve. Kjo përbën një hap konkret drejt përbushjes së objektivave të përbashkëta për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit.

"MISS & MISTER TURIZMI" NË QYTETIN E VLORËS

Në kuadër të strategjisë së Bashkisë Vlorë për promovimin e qytetit si një destinacion turistik atraktiv dhe dinamik, zhvillimi i aktivitetit **"Miss & Mister Turizmi"** në këtë qytet përfaqëson një mundësi të rëndësishme për të ndërthurur turizmin me artin, kulturën dhe imazhin publik të Vlorës.

Ky aktivitet synon të sjellë në vëmendjen e publikut vlerat e mikpritjes, bukuritë natyrore, ofertën kulturore dhe potencialin turistik të qytetit. Përgjedha e Vlorës si qytet pritës mbështetet në disa arsyet të fortë:

Argumentet kryesore:

- Pozicion strategjik dhe vijë bregdetare e pasur** – Vlora ofron një sfond natyror mbresëlënës për zhvillimin e eveneteve që lidhen me estetikën dhe promovimin vizual. Ajo përfaqëson një nga portat hyrëse të turizmit shqiptar.
- Infrastrukturë dhe eksperiençë në organizimin e eveneteve** – Qyteti ka zhvilluar kapacitete organizative për aktivitete të mëdha dhe ka një kalendar aktiv festiv veror, që e bën të përshtatshëm për një event me impakt kombëtar dhe mediatik.
- Promovim i turizmit përmes figurës dhe kulturës së të rinjve** – “Miss & Mister Turizmi” është një format që ndërthyr të rinjtë, modën, trashëgiminë dhe identitetin lokal me mesazhe promovuese për destinacionin turistik ku zhvillohet.
- Rritja e vizibilitetit në media dhe rrjetet sociale** – Evenete të tillë gjenerojnë përbajtje vizuale dhe lajme që përhapen gjerësisht, duke shërbyer si reklamë e drejtpërdrejtë për qytetin dhe ofertën e tij turistike.
- Kontribut në ekonominë lokale** – Aktiviteti do të përfshijë struktura akomoduese, operatorë turistikë, artistë dhe biznese vendase, duke gjeneruar ndikim të drejtpërdrejtë ekonomik dhe social.

Organizimi i aktivitetit “**Miss & Mister Turizmi**” në qytetin e Vlorës është një nismë që i shérben promovimit të qytetit në nivele kombëtare dhe ndërkombëtare, duke i dhënë imazh rinos, festiv dhe mikpritës. Ai përputhet me vizionin e Bashkisë për të pozicionuar Vlorën si qendër moderne turizmi, arti dhe kulture.

DREJTOR

Arlinda Tepelena

